



VENDIM

Nr. 31 Date 13.10.2014

**PER MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TE MIREKUPTIMIT (MIM) MES KESHILLIT
TE QARKUT KUKES DHE EURO PARTNERS DEVELOPMENT (EPD) - TIRANË**

Keshilli i Qarkut Kukes ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, pas shqyrtimit te Relacionit te paraqitur nga AZHR-ja, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore,, nenet 7/2, 8/1/b,13, 19,54, ligjin Nr.8485 date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise", VKM Nr.775, datë 24.09.2010 "Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë", udhezimit Nr.8 date 17.02.2002 "Per evidencimin, regjistrimin, perdorimin dhe raportimin e financimeve te huaja ne kuadrin e projekteve dhe marreveshjeve me donatoret e huaj" si dhe vendimin e Kryesise se Keshillit te Qarkut Kukes Nr.20, date 13.10.2014 "Per miratimin e P/Akteve per mbledhjen e Keshillit te Qarkut Kukes".

VENDOSI:

1. Miratimin e memorandumit te mirekuptimit (MIM) mes Keshillit te Qarkut Kukes dhe Euro Partners Development (EPD), Tiranë ne kuader te projektit IPA ĆBC: "*Green Business (Biznesi i Gjelber)*", bashkangjitur ketij vendimi.
2. Te autorizojë Kryetarin e Keshillit te Qarkut Kukes per nenshkrimin e memorandumit te mirekuptimit me Euro Partners Development (EPD) - Tiranë.
3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen, Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukes, Agjensia e Zhvillimit Rajonal, si dhe Zyra e Finances
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Konc: I.Shahu

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi

U hartua ne 4 (kater) kopje origjinale:

1. Zyres se Arkivit
2. Institucionit te Prefektit te Qarkut Kukes
3. Agjensise se Zhvillimit Rajonal

KRYETARI

Ibsen ELEZI

